

V E N D I M
Nr.248, datë 28.5.1999

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LEJES PËR FUNKSIONIMIN E
INSTITUCIONEVE ARSIMORE JOPUBLIKE DHE TË INSTITUCIONEVE
ARSIMORE PLOTËSUESE JOPUBLIKE, KU ZHVILLOHEN LËNDË FETARE OSE
KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHË TË HUAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Objekt i këtij vendimi janë instituconet arsimore jopublike dhe institucionet arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj. Këto institucione arsimore funksionojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me konventat, traktatet dhe marrëveshjet e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, duke respektuar realitetin shqiptar, arritjet dhe traditat e shkollës kombëtare, shqiptare.

2. Subjektet private, që do të funksionojnë si institucone arsimore jopublike apo si institucione arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj paraqesin kërkesën pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet edhe me këto dokumente:

a) Deklaratën, në të cilën subjekti merr përsipër respektimin e dispozitave ligjore e nënligjore, që rregullojnë funksionimin e institucioneve arsimore jopublike dhe të institucioneve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, të Deklaratës Universale të së Drejtave të Njeriut dhe të Konventës të së Drejtave të Fëmijëve.

b) Vendimin e gjukatës së rrethit të Tiranës për regjistrimin si person juridik në Regjistrim Tregtar, ku të jetë përcaktuar objekti i veprimtarisë në fushën e arsimimit, formimit dhe edukimit.

c) Dokumentacionin e nevojshëm, që vërteton se kërkuesi ka një ndërtesë, truall dhe mjedise të tjera ndihmëse për funksionimin normal të instituconeve arsimore jopublike. Për ndërtesat, trojet dhe mjediset e tjera, që janë pronë shtetërore, nuk do të pranohet kontrata e uzurfruktit.

ç) Vërtetim nga Inspektorati sanitar dhe organet e pushtetit vendor, se ndërtesa dhe mjediset e tjera ndihmëse plotësojnë kushtet higjieno-sanitare, të mbrojtjes kundër zjarrit dhe kërkesat e tjera të të qenit institucion arsimor, sipas normave ligjore. Ky vërtetim duhet të marrë parasysh rregullat për sigurimin e jetës e të shëndetit, të mësuesve shqiptarë e të huaj, si dhe dispozitat e ligjit për shërbimin shëndetësor, stomatologjik në shkolla, si dhe rregulloren e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për shërbimin shëndetësor në institucionet parashkollore dhe shkollore.

d) Garancinë për burimet e financimit, së bashku me tarifën e frekuentimit për nxënësit.

e) Dokumentin e numrit të identifikimit si person i tatueshëm, së lëshuar nga zyra e tatim-taksave e degës pranë së cilës ai ushtron veprimtarinë, për shlyerjen e detyrimeve fiskale.

ë) emërtimin e institucionit arsimor jopublik, adresën, llojin e institucionit dhe titullin e dokumentit, që lëshohet në përfundim të tij apo të çdo viti shkollor.

f) Planin dhe programet mësimore, që do të zhvillojë institucioni. Struktura e vitit shkollor e institucioneve arsimore jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, të jetë e barasvlefshme me atë të shkollave publike të të njëjtit nivel, së bashku me kalenarin e veprimtarive vjetore. Për institucionet arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, duhet të përcaktohet

kohëzgjatja, struktura, nivelet apo modulet e formimit që zhvillojnë.

g) Listën e plotë të stafit drejtues, mësimdhënës e ndihmës. Përcaktimi i drejtorit administrativ dhe i drejtuesit për problemet mësimore - edukative. Për stafin administrativ dhe mësimor-edukativ duhet të paraqiten diplomat përkatëse, vërtetimet për kualifikimet e kryera, dëshmia e penalitetit, së bashku me disa gjeneralitete. Kur pjesëtarë të këtij stafi nuk janë shtetas shqiptarë, përveç kërkesave të mësipërme do të paraqesin edhe dokumentacionin e përcaktuar, sipas dispozitave ligjore për të huajt. Ky dokumentacion do të rinovohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës çdo fillim viti shkollor, sipas ndryshimeve të mundshme, në rast se ka të tilla.

gj) Listën e teksteve bazë, që do të përdoren nga ky institucion:

- lëndët mësimore të detyrura njëloj me ato të shkollave publike;

- lëndët mësimore të ndryshme nga ato të planeve mësimore të institucioneve ekuivalente, publike;

- lëndët me zgjedhje dhe ato fakultative.

Këto tekste duhet t'u vihen në dispozicion organeve arsimore, kur një gjë e tillë kërkohet nga ata.

h) Listën e bazës materiale, didaktike, që ka institucioni arsimor jopublik në shërbim të realizimit të kërkesave të planit e të programit arsimor.

i) Miratimin nga Sekretariaati Shtetëror i Fesë, i planit mësimor, i programeve lëndore dhe i teksteve të pjesës jolaike, për subjektet fetare, vendase apo të huaja, dhe për subjektet që përfaqësojnë subjektet fetare në Shqipëri, që drejtojnë e organizojnë institucionet arsimore jopublike dhe institucionet arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare.

j) Rregulloren e brendshme të institucionit, e cila duhet të ketë si qëllim përcaktimin e raporteve ndërmjet drejtuesve, personelit mësimdhënës dhe ndihmës, nxënësve, prindërve, etj.

k) Rregullat dhe kriteret e vendosura nga institucionet për pranimin e personelit dhe të nxënësve.

3. Institucioni arsimor jopublik dhe institucioni arsimor plotësues jopublik, ku zhvillohen lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj duhet të ketë regjistër amze, regjistër të veçantë, regjistër klasre apo formularët e tjerë, që në këto institucione përdoren si dokumentacione bazë. Në çdo rast këto dokumente u vihen në dispozicion organeve arsimore.

4. Pas dorëzimit të të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, me përmbushjen e afateve ligjore të nevojshme, Ministria e Arsimit dhe shkencës paraqet kërkesën për dhënie të lejes së institucionit arsimor jopublik dhe institucionit arsimor plotësues jopublik, ku zhvillohen lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, për miratim në Këshillin e Ministrave.

5. Institucioni arsimor jopublik dhe institucioni arsimor plotësues jopublik, ku zhvillohen lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, bazuar në strukturën e sistemit arsimor apo të kursit që ndjek, duhet të lëshojë dëftesë apo certifikatë notash ose aftësie për përfundimin e një cikli arsimimi.

6. Institucioni arsimor jopublik dhe institucioni arsimor plotësues jopublik, ku zhvillohen lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj duhet të informojë organet arsimore për veprimtaritë e ndryshme që zhvillon jashtë procesit arsimor. Pjesëmarrja e nxënësve në to është fakultative. Miratimi nga prindi, kujdestari, apo nga vetë nxënësi është përcaktues në këtë pjesëmarrje. Këto veprimtari organizohen nga një personel i specializuar dhe në përshtatje me grupmoshat.

7. Këto institucione duhet që për projektet dhe eksperimentimet, me karakter psikopedagogjik e didaktik, të informojnë organet arsimore, qendrore apo në rrethe, pasi të kenë përcaktuar motivin dhe objektivat përkatëse. Projekti duhet të dorëzohet për miratim pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës jo më vonë se dy muaj para fillimit të vitit të ri shkollor. Ecuria e projektit ndiqet me përparësi nga specialistët, duke bërë vlerësimet dhe përgjithësimet e nevojshme.

8. Institucioni arsimor jopublik dhe institucioni arsimor plotësues jopublik, ku zhvillohen

lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj duhet të dorëzojë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, brenda afateve të përcaktuara, të gjitha të dhënat sipas standardeve të miratuara nga Instituti i Statistikës, si dhe të dhëna të tjera, më të detajuara, që mund të kërkohen nga Ministria e Arsimit dhe shkencës, për veprimtarinë e tyre arismore.

9. Ministria e Arsimit dhe Shkencës përcakton kushtet dhe mënyrat për njohjen e certifikatave dhe të diplomave që lëshohen nga institucioni arsimor, jopublik në përfundim të një klaser apo cikli, si edhe të dëshmieve që lëshohen nga institucioni arsimor plotësues jopublik në përfundim të tyre.

Përfaqësuesi ligjor i institucioneve arsimore jopublike dhe të institucioneve arsimore plotësuese jopublike ku zhvillohen lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të vitit të ri shkollor bën rishikimin e të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, pasqyron ndryshimet e mundshme në rast se ka, plotëson dhe paraqet formularin e përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për gatishmërinë për fillimin e vitit të ri shkollor, paraqet kontratat e punës meee të punësuarit dhe dokumentacionin përkatës për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore për arsimimin, edukimin, formimin dhe kualifikimin në institucionet arsimore jopublike (me kohë të plotë e të pjesshme) dhe të instituconeve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko